

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Per pasqyren e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera ne fushaten zgjedhore 2009, nga Partia "Bashkimi Liberal Demokrat".

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, Tirane

Ne kemi audituar pasqyren bashkalidhur te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera te Partise " **Bashkimi Liberal Demokrat**" per periudhen 28 Maj 2009 deri 28 Qershor 2009. Kjo pasqyre eshte pergjegjesi e drejtimit te Partise "**Bashkimi Liberal Demokrat**". Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi kete pasqyre bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Keto standarte kerkojne, qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditim per te zoteruar siguri te arsyeshme, se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtetin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres. Ne çmojme se auditimi yne perben nje baze te arsyeshme per te shprehur nje opinionin tone.

Politika kontabile e ndjekur nga ana e shoqerise eshte te pergatise pasqyren bashkelidhur mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se fushates zgjedhore. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne lek ose ne materiale dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Per mendimin tone, pasqyra bashkalidhur jep nje pamje te vertete e te sinqerte te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera nga " **Bashkimi Liberal Demokrat**" gjate fushates zgjedhore ne periudhen 28 Maj 2009 deri ne 28 Qershor 2009, ne perputhje me kohen e perfitimit dhe kryrjes se shpenzimit, siç pershkruhet ne Shenimin II.

Eksperti Kontabel i Regjistruar

Sabri PALAMANINr LIC 125

Data 31.10.2009

PARTIA "Bashkimi Liberal Demokrat"

FONDET E PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009, ne leke

Nota	Pershkrimi sipas natyres	Vlera	%
1	Fondet e marra	1.143.743	
1.1	Nga fondet publike	1.114.743	
1.2	Donacionet e perfituara ne vlere monetare nga (<i>fondet jo publike</i>) :		
1.2.1	-	0	
1.2.2	-	0	
1.2.3	-	0	
1.2.4	-Perfitime me pak se 100.000 leke	0	
1.3	Donacionet e perfituara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu	0	
1.3.1	- Sherbime reklame	0	
1.3.2	- Pritime, flamuj ,adezivetj	0	
1.4	Perfitime nga reklama televizive sipas nenit 84, pika 6.		
1.4.1	-Top Channel sha	0	
1.4.2	-Media Vision sha	0	
1.4.3	-TV-Asat sha	0	
1.4.4	-Media 99 sha	0	
1	Shuma totale e fondeve	1.114.743	
2	Shpenzimet te kryera per fushaten zgjedhore ne periudhen 28.05.09-28.06.09	296.000	
2.1	Marje salle me qera	75.000	
2.2	<i>Spote publicitare</i>	221.000	
2.2.1	- TV New 24	114.000	
2.2.2	- TV A1	12.000	
2.2.3	-TV-Asat sha	82.000	
2.2.4	- TV Koha	13.000	
2.3	Konsulence per fushaten	0	
2.3.1	-	0	
2.3.2	-	0	
2.4	Shpenzime telefonike	20.917	
2.4.1	-AMC	20.000	
2.4.2	-Albtelekom	917	
2.5	Postera, fletevolante, fletepalosje, reklame, banderola	431.000	
2.5.1	-Shtepia Botuese M & B (sherbim reklame)	333.000	
2.5.2	-Pritime , bandiera ,adeziv etj	0	
2.5.3	-Dekor Tirana (fletepalosje,fletevolante,postera)	98.000	
2.6	Shpenzime kancelerie	45.000	
2.6.1	- Shtypshkronja Print 2008	45.000	
2.6.2	-FBS shpk	0	
2.6.3	-Infinity	0	
2.6.4	- Te tjere	0	
2.7	SMS Promocionale	0	
2.8	Karburante	110.000	
2.9	Energji elektrike	2.800	
2.10	Pagat e punonjesve dhe kontributet	53.160	
2,10.1	Pagat e punonjesve	40.000	
2.10.2	Sigurmet Shoqerore shendetsore, Tatimi mbi te ardhurat personale	13.160	
2	Totali Shpenzimeve	958.877	

Financieri
Halil RAMAKryetari i Partise B L D
Arian STAROVA

PARTIA "Bashkimi Liberal Demokrat"
Shenime per pasqyren financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2009

I. Te Pergjitheshme

Partia "Bashkimi Liberal Demokrat" (BLD), e krijuar me vendim gjykate Nr. 2122 date 13.04.2005, eshte nje organizate politike e pavarur krijuar ne konformitet te plote me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe legjislacionin ne fuqi. Qellimi dhe objektivat e kesaj partie te percaktuara ne program e statut synojne ne realizimin e aspirates per nje Atdhe qe rilind e perparon drejt qellimeve te medha per nje zhvillim te balancuar te vendit, per ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave njerezore, per lartesimin e integritetit dhe dinjitetit kombetar, per integrim te shpejte ne familjen europiane, per marredhenie shoqerore, dinjitet dhe paqe. Partia "**Bashkimi Liberal Demokrat**" synon te ndikojte ne jeten e vendit nepermjet pjesemarrjes ne zgjedhjet dhe perfaqesimit te popullit ne organet e zgjedhura te pushtetit.

- Partia "**Bashkimi Liberal Demokrat**" eshte regjistruar si person juridik me iniciale BLD.
- Qellimi i saj eshte percaktuar ne akt themelimi dhe statut
- Gjithashtu ne statut jane percaktuar te drejtat dhe detyrat e anetareve te partise
- Organet drejtuese ne nivel qendror te Partise jane :
 - Keshilli Kombetar (K.K)
 - Kryesia
 - Kryetari
 - Nenkryetari
 - Sekretari i Pergjithshem
- Burimet financiare te Partise jane:
 - Te ardhurat nga kuotizacionet
 - Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me legjislacionin per financimin e partive politike
 - Cdo e ardhur tjeter qe nuk bie ne kundertshtim me legjislacionin per financimin e partive politike.
- Selia e Partise eshte ne Tirane, ne Bulevardin "Zhan D'ARK", nr. 16.
- Numri i anetareve te Partise eshte mbi 5000 shtetas shqiptare me banim te perhershem ne Republiken e Shqiperise

II. Rregullat e Vleresimit

Menyra e pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te drejtave te konstatuara. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes duke i konvertuar ne vlere leku dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

Monedha Raportuese

Partia ka perdorur ALL si monedha e baze e raportimit.
Fondet e perfituara jane mare ne leke ..
Shpenzimet jane kryer ne ALL.

Taksat dhe Kontributet

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore te punonjesve dhe per tatimin mbi te ardhurat personale.

1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009.

1.1 FONDET PUBLIKE

Me daten 17.06.2009 jane kaluar ne llogarine tone prane BKT/1 , nga Dega e Thesarit,Tirane shuma **240.743** leke si shtese fondi per fushaten zgjedhore ne mbeshtetje te shkreses 6883/1, date 17.06.2009

1.2 FONDET JO PUBLIKE (ne vlere monetare)

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar fonde jo publike per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

1.3 DONACIONET E PERFITUARA NE SENDE DHE SHERBIME TE VLERESUARA ME VLERE TREGU.

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar Donacione per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

1.4 PERFITIME NGA REKLAMA TELEVIZIVE SIPAS NENIT 84, PIKA 6 E KODIT ZGJEDHOR.

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar nga reklamat televizive per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

2. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009

2.1 **Marrje salle me Qera.** Sipas kontrates nr - date 09.06.2009 te lidhur me TKOB, eshte mare me qera salla e madhe e koncerteve ne Pallatin e Kultures per daten 14 Qershor 2009 , ne te cilen eshte bere hapja zyrtare e fushates zgjedhore te BLD-se.TKOB ka leshuar fature tatimore shitje me nr.40 date 20.05.2009 ne vleren **45,000** leke , shume e cila eshte likuaduar nga llogaria jone bankare 9748 ne Banka Credins ne daten 09.06.2009.

2.2 REKLAMA TELEVIZIVE DHE TRANSMETIME SPOTESH

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar nga reklamat dhe spotet televizive per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009.

2.3 KONSULENCE E HUAJ PER FUSHATEN

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar konsulence te huaj per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

2.4 SHPENZIME TELEFONIKE

2.4.1 Sipas faturave te Alb Telecom dhe AMC, gjate muajit Qershor 2009 shpenzimet per telefonin celulare kapin vleren 20.917 leke te cilat jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2009.

2.5 SHPENZIME PER FLETEVOLANTE, FLETEPALOSJE, REKLAMA, BANDEROLA

2.5.1 Sipas faturave tatimore te shitjeve Nr 24 e 25 date 01 dhe 05.06.2009, shtypshkronja „BEJKO" dhe Dekor Tirana kane faturuar sherbime reklame ne vleren **431,000** leke , per fushaten zgjedhore 2009.

2.6 SHPENZIME KANCELARIE

2.6.1 Sipas fatures tatimore shitje nr.18 date 17.06.2009, te shtytypshkronjes'PRINT shtytypshkronjes'PRINT' shpk, ka faturuar materialet kancelerike te perdorura gjate fushates zgjedhore ne vleren **45.000** leke ,te cilat konsiderohen si shpenzime te fushates.

2.7 MESAZHE PROMOCIONALE.

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka perfituar mesazhe promociionale per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

2.8 **KARBURANTE**, me faturat tatimore shitje nr 482 date 01.06.2009 dhe nr 547. date 09.06.2009, te « VILOIL » Shpk ka faturuar karburantin ne vleren totale 110.000 leke i perdorur gjate fushates zgjedhore 2009. Ndarja e karburantit eshte bere ne baze te nje plani te miratuar per levizjen e mjeteve gjate fushates.

2.9 **ENERGJIA ELEKTRIKE**, sipas fatures se OSSH sha gjate muajit Maj 2009 eshte harxhuar 2,784 leke energji elektrike qe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten.

2.10 PAGAT E PUNONJESVE DHE KONTRIBUTET.

2.10.1 Pagat e punonjesve te muajit qershor 2009 ne vleren 40,000 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2009.

2.10.2 Sigurimet shoqerore dhe shendetesore si dhe tatimi mbi te ardhurat personale ne vleren 13,160 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2009.

3 LLOGARITE BANKARE DHE LEVIZJA E TYRE GJATE PERIUDHES 28.05.2009 DERI ME 28.06.2009.

Gjendja e likuiditeteve ne arke e banke me 28.06.2009, *eshte e ndare si me poshte:*

	28.05.2009	USD	28.06.2009
Para ne arke	214.707	-	707
Banka	1,753.199	-	1.919.065
Banka			
TOTAL	1.967.906		1.919.772

Partia "Bashkimi Liberal Demokrat" gjate fushates 2009 ka operuar nepermjet llogarise bankare Nr 9748 te çelur ne Banken Kombetare Tregetare , Tirane .

Llogarite e celura prane bankave dhe levizja e tyre gjate periudhes 28/05/2009 deri 28/06/2009

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	28/05/2009	Hyrjet	Daljet	30/06/2009
1	BKT 1	Çelur nga thesari	9748	1.753.199	1.114.743	948.877	1.919.065

Levizja e Cash flow gjate fushates zgjedhore (arka dhe banka)

Pershkrimi	Leke	USD	Total
Gjendja ne daten 28/05/2009	1.967.906	-	1.967.906
Hyrjet gjate fushates	1.814.743	-	1.814.743
Daljet gjate fushates	1.862.877	-	1.862.877
Gjendja ne daten 30/06/2009	1.919.772	-	1.919.772

4 FURNITORET E KRIJUAR GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009 DHE LIKUIDIMI I TYRE DERI NE MOMENTIN E AUDITIMIT.

Partia "Bashkimi liberal Demokrat" nuk ka detyrime te pashlyera ndaj furnitoreve dhe kreditoreve te tjere per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 .

5. REGJISTRIMI I FONDEVE JO PUBLIKE

Per regjistrimin e fondeve jopublike qe mund te perfitoheshin gjate fushates zgjedhore 2009 ,eshte patur parasysh regjistri i posaçem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se duke patur parasysh qe te pasqyroheshin te gjitha shumat e perfituara si dhe te dhena te tjera qe lidhen me indetifikimin e qarte te dhuruesit. Ne castin e dhurimit, ata e duhet te nenshkruanin nje deklarate, ku te zotohen se nuk ndodhen ne nje nga rrethanat e percaktuara ne nenin 89 te Kodit Zgjedhor dhe se mbajne pergjegjesi personale per deklarate te rreme. Forma dhe permbajta e deklaratave te cilat duhet te nenshkruheshin nga dhuruesit eshte ajo e miratuar nga KQZ-ja.

Per dhurimin e fondeve publike eshte çelur nje llogari e posaçme prane Bankes Credins me Nr 171864, per te cilen kemi njoftuar dhe deklaruar prane KQZ me daten 29.05.2009.

Shpenzimet totale qe ka kryer BLD-ja per fushaten zgjedhore nuk e kalojne kufirin e percaktuar ne nenin 90 te ketij ligji. Te gjitha shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane dokumentuar duke respektuar legjislacionin tatimor ne fuqi.

Ne keto pasqyra jane perfshire te gjitha fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga BLD-ja ne qender dhe ne qarqe.

6. NGJARJE TE MEVONESHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Financieri

Halil RAMA

Kryetari i Partise B L D

Arian STAROVA